



# Mbrojtja kundër dhunës ndaj femrave ne Gjermani

botimi i ripunuar



Udhëzues për femra refugjate, emigrante dhe të rinj

Mbështetur nga:



Die Beauftragte der Bundesregierung  
für Migration, Flüchtlinge und  
Integration

Ethno-  
Medizinisches  
Zentrum e.V.



## Impressum

Gewaltschutz für Frauen in Deutschland –  
Ratgeber für geflüchtete Frauen, Migrantinnen und Jugendliche

### Herausgeber:

Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.  
Königstraße 6, 30175 Hannover

### Konzeption, Inhalt, Erstellung:

Duale Hochschule Baden-Württemberg Villingen-Schwenningen (DHBW)  
– Institut für Transkulturelle Gesundheitsforschung

Ethno-Medizinisches Zentrum e.V. (EMZ e.V.)  
– MiMi Integrationslabor Berlin (MiMi Lab)

**Förderung:** Beauftragte der Bundesregierung für Migration, Flüchtlinge und Integration

**Projektleitung:** Ramazan Salman (EMZ e.V.), Prof. Dr. Dr. Jan İlhan Kizilhan (DHBW)

**Redaktion:** Jasmin Bergmann, Dagmar Freudenberg, Sarah Hoffmann, Olga Kedenburg, Ahmet Kimil, Prof. Dr. Dr. Jan İlhan Kizilhan, Claudia Klett, Gabriele Martens, Ass. iur. Isabell Plich, Anne Rosenberg, Andreas Sauter, Ramazan Salman, Prof. Dr. Karin E. Sauer, Prof. Dr. Anja Teubert, Susanne Winkelmann, Lutz Winkelmann RA

**Layout und Satz:** eindruck.net

**Übersetzung:** Dolmetscherdienst – Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.

**Bildquellen:** Umschlagbild und Bild auf Seite 16 © Tom Platzer „Styling time4africa“  
Ministerin Widmann-Mauz: Bundesregierung/Kugler · Seite 2: © iStock, imagesbybarbara  
Seite 5, 22, 25, 29: © Fotolia · Seite 11: © iStock, m-imagephotography

Alle Rechte vorbehalten. Das Werk ist urheberrechtlich geschützt. Jede Verwendung in anderen als den gesetzlich zugelassenen Fällen bedarf deshalb der vorherigen schriftlichen Genehmigung durch den Herausgeber.

Diese Publikation können Sie jederzeit über die Webseiten „[www.mimi-gegen-gewalt.de](http://www.mimi-gegen-gewalt.de)“ oder „[www.mimi-bestellportal.de](http://www.mimi-bestellportal.de)“ in folgenden Sprachen anfordern: Deutsch, Albanisch, Arabisch, Bulgarisch, Dari, Englisch, Farsi, Französisch, Kurdisch, Paschto, Polnisch, Rumänisch, Russisch, Serbisch/Kroatisch/Bosnisch, Spanisch, Italienisch, Türkisch und Vietnamesisch

3. Auflage · Stand: November 2018

# Hyrje

Të dashur lexuese dhe lexues,

që nga viti 2016 ekziston projekti “MiMi – parandalimi i dhunës me emigrante për emigrante” në të gjithë Gjermaninë. Me anë të këtij projekti duam t’u japim forcë grave dhe vajzave të arratisura dhe të kontribuojmë, që persona të prekur ose të kërcënuar nga dhuna e seksuale të informohen për të drejtat dhe mundësitë e tyre për t’u mbrojtur.



Duke i vështruar shifrat, nevoja për këtë duket qartazi: Në tre vitet e fundit kishte 1,36 milionë kërkesa të para për azil, 463.000 ose 34% prej tyre të parashtruara prej grave. Jo gjithsecila prej tyre ka nevojë për përkrahje për parandalimin e dhunës. Sado, shumë gra kanë përjetuar dhunë tashme në vendet e tyre të origjinës ose gjatë arratisjes ose e kanë pësuar në trupin e vet. Shumë prej tyre e kanë të vështirë të flasin për dhunë seksuale. Gjithashtu, gratë përqendrohen më shpesh në afërsi të drejtpërdrejte të institucioneve të pranimit dhe normalisht largohen prej tyre më rrallë se burrat. Prandaj, projekti i kthehet formatit të sprovuar të punës me ndërmjetësuese të Qendrës Etno-Mjekësore: Ndërmjetësueset e dinë nga përvoja e vet, sa sfiduese mund të jetë ardhja në një mjedis të ri dhe në një ambient ende totalisht të panjohur. Kjo vlen veçanërisht, kur veç kësaj ekzistojnë edhe përvoja traumatike.

Ndërmjetësueset vijnë direkt në institucionet e pranimit dhe të strehimit të përbashkët dhe në zonën familjare. Atje, ato u japin grave dhe vajzave të reja njohuri për të drejtat humane, të drejtat e fëmijëve për mbrojtje dhe të drejtat e grave, dhe ua tregojnë atyre, se si mund të mbrohen nga shkeljet. Në këtë, ato punojnë me ndjeshmëri ndaj kulturave, gjuhëve dhe gjinive. Gëzohem që projekti që nga viti 2018 fokusohet edhe në oferta parandaluese për burra dhe i arsimon ata për të qenë ndërmjetësues. Sepse një jetë e përbashkët plot respekt dhe pa dhunë do të realizohet vetëm atëherë, nëse gra dhe burra të përfshihen njëkohësisht.

Shpresoj, që mund t’ju përkrahim ju, të dashur lexuese dhe lexues, me anë të kësaj broshure në punën tuaj të rëndësishme në ndihmën e refugjatëve.

*Annette Widmann-Mauz*

Annette Widmann-Mauz  
Ministre Shteti pranë Kancelares Federale dhe Personi Përgjegjës i Qeverisë Federale për Migracionin,  
Refugjatët dhe Integrimin



# Përmbajtja

## 1. Migrimi, ikja dhe dhuna ..... 4

Dhuna si arsye për ikje | Dhuna gjatë ikjes  
Dhuna në vendet e strehimit për refugjatë | Dhuna pas ikjes

## 2. Format e dhunës ..... 8

Dhuna e drejtpërdrejtë | Dhuna strukturore | Dhuna institucionale

## 3. Dhuna kundër femrave dhe fëmijëve ..... 12

Kush janë autorët? | Arsyet e dhunës kundër femrave dhe fëmijëve  
Shembuj të dhunës kundër femrave dhe fëmijëve | Pasojat e dhunës kundër femrave dhe fëmijëve

## 4. Rrugëdalja nga dhuna ..... 26

Mbrojtja ligjore për viktimat e dhunës në Gjermani | Së bashku të lira nga dhuna

## Fjalorth ..... 32

## Adresa të zgjedhura kontakti..... 36

# 1. Migrimi, ikja dhe dhuna

## DHUNA SI ARSYE PËR IKJE

**Dhuna** është një nga arsyet pse femrat ikin. Kjo ka lidhje me faktin se femrat ende nuk gëzojnë të drejta të barabarta me burrat në tërë botën. Vërtet, 143 vende kanë miratuar të drejta të barabarta për femrat, barazinë gjinore dhe mos diskriminimin në kushtetutën e tyre deri 2014. Mirëpo mendime kulturore dhe fetare të trashëguara i zhvlehtësojnë femrat në krahasim me meshkujt në të gjithë botën.

### **Situata ligjore:**

Komisioni për të drejtat e femrave (CSW) është themeluar në vitin 1949 për të përmirësuar *pozitën* politike, ekonomike dhe sociale të femrave. Konventa për eliminimin e çdo forme të diskriminimit kundër femrave (Convention On The Elimination Of All Forms Of Discrimination Against Women – CEDAW) është miratuar në vitin 1979. Në vitin 2015 është ratifikuar nga 189 shtetet. Edhe Gjermania e ka nënshkruar dhe ratifikuar atë.

**Dhuna gjinore (si për shembull dhuna seksuale apo dhuna në familje) është vepër penale.** Për këto vepra penale mund të paraqiten padi në gjykatë. Kjo përfshin, për shembull, dhunën në familje.

Dhuna seksuale dhe dhuna në familje përdoren, gjithashtu, si mjete për të mbajtur dhe vazhduar dominimin mbi femrat nga ana e burrave.

Shembuj të këtij dominimi janë:

- gjymtimi i organeve gjinorale të femrave, i cili ndodh ende pavarësisht ndalimeve zyrtare;
- marrëdhënie të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe femrave, të ashtuquajtura *marrëdhënie varesie\**, femrat konsiderohen si “mall” dhe aktivitetet seksuale si “valutë”. Pasojat janë shpesh martesat e detyruara, por edhe prostitucioni i detyruar apo për arsye të varfërisë dhe trafikimi i qenieve njerëzore.
- *abuzimi* i femrave dhe fëmijëve nga persona që punojnë në shërbimin e shtetit (polici, ushtri apo në shërbime të tjera shtetërore) në vendlindje, si për shembull gjatë arrestimit ose marrjes në pyetje;
- dhuna seksuale për arsye politike me qëllimin e dominimit apo çrrënjësjes së disa grupeve të popullsisë përmes përdhunimeve sistematike. Në këtë kontekst bëhet fjalë për *“spastrime etnike”*, dhuna seksuale përdoret si arme luftarake për poshtërimin apo shpërbërjen e komuniteteve. Femrat burgosen në kampe përdhunimi (rape camps).

\* Termat e sqaruara në fjalorth shkruhen me shkronja të pjerrëta.

– lënia pas dore e fëmijëve të sapolindur nga përdhunimet në luftë, apo në rastin më ekstrem vrasja e atyre. Fëmijët e mbijetuar nuk gëzojnë asnjë siguri në komunitetet e nënave të tyre dhe nuk mbrohen nga ligji. Nganjëherë ata duhet të punojnë për ushtrinë apo luftojnë si të ashtuquajtur ushtarë fëmijë, d.m.th. si fëmijë që i kanë humbur prindërit e tyre në luftë (jetimë lufte).

Përveç arsyeve të tilla si dhuna kundër femrave dhe fëmijëve, ka edhe arsye të tjera për ikje, për shembull lufta dhe *dëbimi masiv*. Por edhe vetë ikja mund të jetë e rrezikshme për femrat dhe fëmijët. Shpesh, gjatë ikjes, ata janë të ekspozuar ndaj dhunës.

## DHUNA GJATE IKJES

Femrat rrezikohen veçanërisht nga dhuna gjatë ikjes. Ato mund të ngacmohen apo përdhunoohen nga piratët, hajdutët, anëtarët e forcave të sigurisë, kontrabandistë dhe madje refugjate të tjerë. Për shembull, oficerët e policisë kufitare mundën të ndalojnë femra dhe fëmijë dhe t'i përdhunojnë për një kohë të gjatë. Piratët i marrin femrat peng dhe i shtrëngojnë të bëjnë seks dhe i lejojnë të vazhdojnë udhëtimin vetëm pas një akti të tillë. Kontrabandistët i ndihmojnë femrat dhe fëmijët për të kaluar kufirin, por për këtë kërkojnë seks apo para/sendë me vlerë.





Personat e mëposhtëm *rrezikohen* më së shumti nga dhuna seksuale apo dhunë tjetër gjatë ikjes:

- femra që udhëtojnë vetëm me apo pa fëmijë;
- femra shtatzëna apo femra që i japin gji foshnjës;
- vajza të reja dhe fëmijë të pashoqëruar;
- fëmijë të martuar herët – disa me bebe të porsalindura me vete;
- persona të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara;
- persona që nuk janë të aftë të komunikojnë.

Gjatë rrugës, refugjatët shpesh banojnë në kampe për një kohë mjaft të gjatë. Gjate udhëtimit, kampet janë shpesh mundësia e vetme e strehimit. Atje rreziku nga dhuna është i madh. Në kampe të tilla, refugjatët janë të varur nga organizata që kanë për detyrë të kujdesen për banorët dhe të sigurojnë mirëqenien e tyre. Kësisoj, refugjatët humbin kontrollin mbi jetën e tyre. Për shembull, kjo mund të shkaktojë një krizë të refugjatët meshkuj, të cilët e shohin që imazhi dhe pozita e tyre në shoqëri janë vënë në rrezik. Nganjëherë, ata reagojnë në mënyrë të dhunshme.

**Ndoshta mund të ketë arsye për veprime dhune. Megjithatë, këto arsye nuk mundën ta justifikojnë apo përligjin dhunën e burrave ndaj femrave dhe fëmijëve. Nuk ka justifikim apo përligjeje për dhunën!**

## DHUNA NË VENDET E STREHIMIT PËR REFUGJATË

Raportohet që numri i akteve të dhunshme kundër femrave rritet gjithnjë e më shumë në vendet e strehimit për refugjatë. Më shumë se dy të tretat e refugjatëve janë burra, shumica e tyre janë më të rinj se 30 vjeç. Mungojnë vende të sigurta për femra apo institucione që janë vetëm për femra.

Ligjet për leje qëndrim dhe azil e vështirësojnë trajtimin e dhunës kundër femrave refugjate. Megjithatë, autoritetet për të huajt mund t'i mbrojnë femrat. Për shembull, mund t'i përjashtojnë femrat në situata të tilla nga *qëndrimi i detyrueshëm* dhe mund t'u ofrojnë banesa apo vende strehimi në qytete dhe rajone të tjera.

Për shembull, për mbrojtjen ligjore në vendet e strehimit ekzistojnë mundësitë e mëposhtme:

- urdhra nga policia që fajtoret duhet të largohen nga vendi i strehimit për një afat të shkurtër;
- masa afatgjate në përputhje me *ligjin për mbrojtje nga dhuna (Gewaltschutzgesetz, GSG)*;
- ndalimi i hyrjes në vendin e strehimit.

Mirëpo, këto masa shpesh ndihmojnë vetëm për një kohë të shkurtër. Dhuna kundër femrave dhe fëmijëve në strehimore ushtrohet gjithashtu nga bashkëbanorë dhe partnerë që udhëtojnë me to. Shpesh ekzistojnë marrëdhënie varësie të ngushta midis partnerëve. Por *azilkërkuessit* dhe *njerëzit që tolerohen*



jetojnë shpesh në mënyrë mjaft të izoluar në vendet e strehimit. E kanë të vështirë të marrin përkrahje apo ndihmë ligjore afër vendqëndrimit. Shumë persona në një situatë të tillë nuk guxojnë të kërkojnë ndihmë ligjore. Disa madje frikësohen që ndoshta do ta humbin leje qëndrimin në Gjermani. Kur femrat paraqesin një kërkesë për azil, ato duhet të arsyetojnë ikjen e tyre. Shumë femra nuk e raportojnë dhunën seksuale, sepse ndihen të turpëruara. Për këtë shkak, kërkesa e tyre varet nga ekzistenca e martesës së tyre.

**Përdorimi i mundësive ligjore nuk ndikon në procedurën e azilit.**

## DHUNA PAS IKJES

Femrat dhe fëmijët refugjatë mund të kenë përvoja të dhunshme jo vetëm në vendet e strehimit. Kjo ndodh gjithashtu në shoqërinë në *vendin ku pranohen*.

Sipas një kërkimi të Susanne Johansson-it, në vitin 2015, më shumë se tre çereku i femrave refugjate në Gjermani raportojnë përjetime të *dhunës psikike*, pak me shume se gjysma e atyre ka përjetuar dhunë fizike dhe një çerek ka përjetuar dhunë seksuale. Amnesty International ka pyetur femra refugjate që raportojnë jo vetëm përjetime të dhunshme gjate ikjes, por gjithashtu një frike të vazhdueshme nga dhuna në Gjermani. Fajtorët ishin partnerë të tyre, persona të huaj,

bashkëbanorë apo madje edhe punonjës të personelit në vendin e strehimit. Format e ndryshme të dhunës janë kryer në publik dhe gjithashtu në vendin e strehimit apo në banesën personale.

Disa njerëz kanë frikë të dalin vetëm nga strehimorja e refugjatëve. Arsyeja është, që ata kanë frikë:

- ndaj ofendimeve dhe fyerjeve në rrugë nga ana e vendasve
- ndaj sulmeve fizike dhe dhunës raciste
- ndaj diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë në shkollë, gjatë formimit profesional ose në vendin e punës

Veç kësaj, në Gjermani në vitet që nga 2015 deri në 2017 kishte mbi 2200 sulme ndaj strehimoreve të azilkërkuesve (p. sh. sulme me zjarrvënie).

Kështu, edhe dhuna raciste është shume e pranishme' ne jetën e refugjatëve. Kjo vlen veçanërisht për të rinjtë.

## 2. Format e dhunës

Dhuna ndodh në situata shumë të ndryshme dhe në shume kontekste. Në parim dallohen tri forma të dhunës:

- Dhuna e drejtpërdrejtë
- Dhuna strukturore
- Dhuna institucionale

**Çdo femër dhe çdo fëmijë ka drejta të barabarta me meshkujt. Ka edhe të drejtën për ndihmë dhe për mbrojtje nga shtypja.**

### DHUNA E DREJTPËRDREJTË

Dhuna e drejtpërdrejtë kryhet nga një person dhe drejtohet kundër personave apo sendeve.

#### **Shembull fëmija:**

Sipas deklaratës së vet, babai e do vajzën e vet dymbëdhjetë vjeçare jashtë mase. Ai i shpjegon asaj, që kjo është arsyeja pse ai ka dëshirë të bëjë ledha me të. Ai dëshiron t'ia prekë gjithë trupin dhe i thotë: "Kështu veprojmë në familjen tonë, prandaj duhet ta durosh dhe nuk të lejohet të flasësh me dikë rreth kësaj." Babai i bën trysni vajzës duke i thënë: "Kjo, çfarë bëjmë, është më se normale, të gjithë ashtu veprojnë. Mamaja jote nuk ka më dëshirë të flejë me mua, prandaj ti duhet ta bësh këtë." Ai e kërcënon, që ai do të futet në burg, nëse ajo flet me dikë rreth kësaj. Kjo gjë quhet abuzim seksual.

Sado, kufijtë e fëmijës mund të shkelen gjithashtu tashme shumë më herët, p.sh. në situata më banale: Gjyshi vjen për vizitë çdo të diel dhe ia kërkon mbesës një puthje si përshëndetje. Kurse vajza nuk ka dëshirë ta puthë, mirëpo dëshira e saj nuk respektohet.

Fëmija mund të mbrohet më mirë nëse mëson

- të thotë "jo" dhe
- nëse të afërmit e tij mësojnë t'i respektojnë këta kufinj.

Abuzimi seksual në familje është një temë shume e komplikuar. Nëse dyshohet, duhet të kontaktohen menjëherë *qendra këshillimore të specializuara*. Këshilltarët që punojnë atje kanë *detyrimin e ruajtjes së fshehtësisë*, domethënë se nuk u lejohet t'u tregojnë asgjë të tjerëve. Gjithashtu, ato mund të japin rekomandime mbi çfarë mund të bëhet më tej dhe mbi mënyrën për t'u mbrojtur.

### **Shembull gruaja në moshë madhore:**

Një burrë e influencon bashkëshorten e vet për vite me radhë të ketë seks me atë kurdo qoftë dëshira e tij. Pra, ai e detyron atë të flejë me të edhe përkundër dëshirës së saj. Ajo duhet ta shfryjë afshin e tij. Në këtë, ai konsideron lëndime shpirtërore por edhe plagosje si të pranueshme. Shpesh gratë binden nga frika, që të goditen, dhe sepse ato mendojnë, se burri ka të drejtë. Këtë mendim edhe shumë partnerë e forcojnë, kur thonë, që ajo vet e ka fajin, nëse ai ushtron dhunë. “Nëse ti nuk kundërshton dhe nëse ti bashkëvepron, atëherë kjo është më mirë për ty”, thotë ai. Ai mendon, që të ketë të drejtën të flejë me gruan e vet edhe atëherë, kur ajo nuk ka dëshirë. Por kjo është gabim dhe në Gjermani dënohet me ligj.

Një formë e tillë e dhunës së drejtpërdrejtë duket shume e qartë. Megjithatë, shume gra nuk përkrahen, sepse familja dhe të afërmit

- shpesh nuk e besojnë se burrat e viktimave mund të kryejnë veprime të tilla;
- mendojnë se seksi është e drejta e burrit dhe se gruaja duhet të beje seks me burrin patjetër;
- këshillojnë se ajo duhet ta tolerojë një gjë të tillë dhe mos të mendoje shume për të. Thonë se nuk ka mundësi të tjera.

## **DHUNA STRUKTURE**

Dhuna strukturore nxitet përmes raporteve të pabarabarta të pushtetit. Që një person të ketë më shumë pushtet mbi njerëz të tjerë, kjo njëherë do të thotë vetëm, që ky person mund të ndikojë në sjelljen e njerëzve të tjerë, me qëllim që kjo të përputhet pak a shumë me dëshirat e veta. Njëherë për njëherë, kjo nuk është diçka e keqe dhe është pjesë e çdo marrëdhënieje midis njerëzve. Veçanërisht midis prindërve dhe fëmijëve të vet, por edhe në çdo lidhje tjetër. Me rëndësi është, që njerëzit e tjerë të mos pengohen në të drejtën për të vendosur për veten e tyre.

### **Shembull:**

Kur burrat fitojnë para për familjet, shpesh kanë pushtetin mbi financat. Posedimi i parave ka shpesh një kuptim shumë të madh, sepse nga këtu rezultojnë varësitë. Nëse humbin para dhe gjëra tjera, njerëzit ndihen të pasigurt dhe të kërcënuar. Ai që ka pushtetin mund t’ua japë të tjerëve këtë siguri, apo t’ua heqë sërish atë. Atëherë, këtë siguri, mund ta humbin pjesëtarët e familjes apo shoqet. Kjo është arsyeja pse pushteti (dhuna strukturore) ka një ndikim të madh te femrat dhe fëmijët në struktura të tilla që përcaktohen nga dhuna.

Kësisoj, dhuna strukturore mbështetet nga mungesa e ekuilibrit të pushtetit. Anëtarët e tjerë të shoqërisë shpesh nuk i gëzojnë të drejtat e veta, ose nuk mundën t'i mbrojnë vetë të drejtat. Ata nuk mund të vendosin çfarë është e mirë dhe e rëndësishme për ta (për shembull, ku dëshirojnë të banojnë).

Pushteti nuk është gjithmonë diçka negative.

Ai që ka pushtet mbi një person tjetër duhet ta ketë të qartë kuptimin e këtij pushteti dhe duhet të silltet me përgjegjësi me të. Është e vërtetë që prindërit kanë pushtet mbi fëmijët e tyre. Fëmijët varen nga prindërit.

Këta të fundit duhet ta përdorin këtë pushtet duke ndihmuar dhe përkrahur fëmijët e tyre. Kjo vlen gjithashtu për përdorimin e parave për jetesë çka duhet të vendoset pa keqpërdorim të pushtetit.

## **DHUNA INSTITUCIONALE**

Dhuna institucionale është një formë dhune që forcon marrëdhënie pushteti përmes strukturave të krijuara apo ekzistuese. Kjo pengon, ndër të tjera, që njerëzit të mund të bëjnë çfarë është e rëndësishme për veten (për shembull në punë, në shkollë apo fjetore ku ka një kohe fikse për të ngrënë apo kur njerëzit janë të varur nga kujdestarë).

Në përgjithësi, dhuna institucionale duhet të forcoj rendin. Popullsia e një shteti përmes rregullave, përjeton gjithashtu sigurinë e trajtimit të barabartë të të gjithëve. Qëllimi është një bashkëjetesë paqësore dhe me mirëkuptim për të gjithë. Megjithatë, kjo situatë nuk duhet të keqpërdoret nga askush, as nga policia, as nga ndihmësit, as nga vetë anëtarët e familjes.

Format e ndryshme të dhunës shpeshherë kanë të bëjnë me njëra-tjetrën dhe ekzistojnë pranë njëra-tjetrës. Shpesh ka disa forma të dhunës në t' njëjtën kohe.

Dhuna ndodh në kultura të ndryshme. Ka gjithashtu dhunë midis kulturave të ndryshme. Dhuna mbështetet për shembull nga të ashtuquajturat struktura shoqërore patriarkale ku burrat shpesh kanë më shumë pushtet dhe femrat shpesh nuk gëzojnë të drejta të barabarta në të njëjtën kohë. Femra mund të marrin pjesë me pak në jetën shoqërore (për shembull sa i përket shkollimit dhe punës).

Por, gjithashtu, pabarazia në shoqëri dhe në tërë botën (shpërndarja e padrejtë e mirëqenies, varfëria, marrëdhëniet midis vendeve të pasura dhe të varfëra) mund ta favorizojë dhunën.



## 3. Dhuna kundër femrave dhe fëmijëve

Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) thekson se dhuna kundër femrave është një nga rreziqet më të mëdha për shëndetin e femrave në tërë botën. Kombet e Bashkuara thonë se çdo veprim që dëmton kanos një femër fizikisht, seksualisht ose psikikisht, përbën dhunë kundër femrave. Edhe *shtrëngimi* dhe *heqja e lirisë në mënyrë të kundërligjshme* në publik apo në jetën private përbëjnë dhunë kundër femrave. Prandaj, ndër të tjera, dallohen format e mëposhtme të dhunës kundër femrave:

### Dhuna fizike, seksuale dhe psikike në familje:

- Dhuna brenda dhe jashtë martesës (për shembull rrahje, abuzim seksual, përdhunim, *cenimi i dinjitetit*, kanosje)
- Abuzimi seksual kundër fëmijëve në familje
- Dhuna që ka të bëjë me prikën
- Çdo praktikë tradicionale që është e dëmshme për gruan (p. sh. gjymtimi i organeve gjenitale)
- Dhuna që ka për qëllim *shfrytëzimin*

### Dhuna fizike, seksuale dhe psikike në komunitet:

- Kanosja, ngacmimi seksual, abuzimi seksual dhe përdhunimi në vendin e punës, në institucione arsimore dhe diku tjetër
- *Trafikimi i femrave dhe prostitucioni i detyruar*

### Dhuna fizike, seksuale apo psikike që kryhet apo tolerohet nga shteti

#### Situata ligjore:

Ushtrimi i dhunës – fizike dhe psikike (“plagosja”) – është e dënueshme ne Gjermani!

## KUSH JANË AUTORËT?

Në 90 për qind të rasteve, autorët janë meshkuj dhe vijnë kryesisht nga mjedisi i ngushtë i personave që i janë nënshtruar dhunës. Ata vijnë nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Autori mund të jetë bashkëshorti, babai, gjyshi, mësuesi, shoku i familjes, trajneri, daja apo xhaxhai, vëllai, prifti apo terapeuti dhe shumë të tjerë. Duke keqpërdorur pushtetin apo duke kryer abuzim seksual, situata e personit që i nënshtrohet dhunës, kryesisht femrës apo fëmijës, shfrytëzohet në mënyrë të veçantë.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) femra vuajnë veçanërisht shpesh nga keqtrajtime nga ana e *partnerëve intim* në disa shoqëri ku pjesërisht barazia midis burrave dhe grave nuk realizohet. Rolet e burrit dhe të gruas janë rreptësisht

të përcaktuara herë pas here, edhe sipas normave kulturore, burri ka të drejtën të bëjë seks. Ndjenjat e gruas nuk konsiderohen. Veprime të tilla shpeshherë nuk dënohen shumë, madje shpesh vlerësohen si diçka e pozitive.

Personat që i janë nënshtruar dhunës shpesh kërkojnë sqarime që mundën ta lehtësojnë autorin. Pasoja është që veprimi i dhunshëm shfaqësohet dhe për këtë arsye, autori motivohet ta përsërisë krimin. Ai ndihet i konfirmuar në mendimin e tij domethënë:

“Vepra ime nuk ka pasoja.”

“Asgjë nuk do të më ndodhë!”

“Të gjithë kanë frikë nga unë dhe të gjithë më respektojnë!”

## ARSYET E DHUNËS KUNDËR FEMRAVE DHE FËMIJËVE

Dhuna kundër femrave mbështetet nga pabarazitë strukturore midis burrave dhe grave dhe forcohet nga:

### – **Struktura patriarkale**

Në struktura të tilla ka ide stereotipe të caktuara për sa i përket burrave dhe grave. Burrëria kuptohet shpesh si pushtet, fuqi dhe *dominim* dhe feminiteti kuptohet shpesh si *tolerancë* (edhe për abuzime) *pasiviteti* dhe inferioriteti;

### – **Qëndrimi sfidues nga ana e burrave që kane shumë kërkesa ngulmuese dhe në të njëjtën kohë, konceptime të epërsisë**

Në këtë kontekst ndodhin shpesh keqtrajtime sepse burri mendon se

është e drejta e tij. Ai mendon se ka të drejtë të vendosë për gjithçka që bën gruaja, edhe për trupin e saj dhe se me kë flet, si ajo vishet dhe ku gjendet.

### – **Pavarësia e shtuar e gruas (në jetën e përditshme dhe në profesion):**

Disa burra ndihen të kërcënuar, kur bashkëshortet e tyre bëhen më të pavarura nga ata në mënyrë financiare dhe sociale.

### – **Pafuqia e burrit (për shembull në procedurën e azilit, mungesa e njohurive të gjuhës, papunësia):**

Kjo mund të çojë në frustrime, të cilat kalojnë në agresion ndaj familjes së vet. Për burrin, kjo gjë mund të jetë një shkarkim emocional afatshkurtër. Pastaj vijon pendimi. Derisa gjithçka fillon përsëri nga e para.

### – **Kërcënimi nga ndarja:**

Gratë që duan të ndahen nga bashkëshorti/partneri i vet, gjejnë vetën në një rrezik dhune shumëfish më të lartë. Burri nuk e duron, sepse ai mendon, që gruaja e tij të ishte pronësia e tij.

Disa burra besojnë, që ushtrimi i pushtetit dhe i kontrollit, i dominimit, i konkurrencës dhe gjithashtu i dhunës fizike i bën pikërisht të jenë një burrë “i vërtetë”. Kjo gjë shpesh sjell konflikte me pretendimin e grave për të drejtat e barabarta në shoqëri.

**Të drejtat e barabarta dhe barazia gjinore në Gjermani mbrohen me ligj.**



Gratë dhe burrat janë mësuar për një kohë të gjatë në rolin e tyre. Për këtë arsye disa mendojnë se edhe dhuna është pothuajse normale. Këto role në të cilat njerëzit janë mësuar dhe trajnuar duhen të ndryshohen në mënyrë afatgjatë. Kjo mund të zgjasë një kohe shumë e gjatë në disa raste por është shumë e domosdoshme për t'i dhënë fund dhunës përfundimisht.

## **SHEMBUJ TË DHUNËS KUNDËR FEMRAVE DHE FËMIJËVE**

Ka dhunë gjinore kryesisht në sferën private, midis partnerëve intime (dhuna në familje) dhe si dhunë seksuale.

### **DHUNA NË FAMILJE**

Nuk ka një përcaktim të saktë të *dhunës në familje*. Kryesisht flitet për dhunën që kryhet kundër partneres apo ish-partneren nga ana e partnerit apo ish-partnerit. Me një fjalë ka dhunë midis të rriturve në familje apo në një çift. 90 për qind e autorëve janë meshkuj dhe femra që u janë nënshtruar dhunës. Shpesh edhe fëmijët u nënshtrohen dhunës në të njëjtën kohë.

Dhuna në familje synon kontroll dhe *ushtrimin e pushtetit*. Një karakteristikë është: Ajo zhvillohet mbi të gjitha në fushën private. Ambienti privat, sfera private, këtu e mbron edhe autorin. Gratë dhe fëmijët shpesh nuk duan ose nuk

mund të flasin për veprat. Ata kanë frikë nga dhuna e burrit/babait. Gjithashtu shumë kanë frikë, që familja të ndahet nga ana e policisë, nëse ata të tregojnë diçka rreth dhunës në familje dhe prandaj heshtin. Ata janë të burgosur në situata shumë të rënduara.

Shembuj të dhunës në familje:

#### **– Dhuna fizike**

Shembuj janë shkulja e flokëve, shuplakat, rrahje me grushte, me pickim, shtyrje, marrje fryme, përdorimi i prangave, sulme me sende të ndryshme (edhe armë).

#### **– Dhuna psikike**

Shembuj janë qesëndia e partneres në sytë e njerëzve të tjerë, kritikime të vazhdueshme për gjëra të vogla, cenime të dinjitetit, akuza të rreme, kanosje, kërcënime ndaj fëmijëve ose kanosja që të largohet me fëmijët deri në kërcënime me vrasje;

#### **– Dhuna seksuale**

Shembuj janë detyrimi apo shtrëngimi për ta bërë praktika seksuale (pa pëlqim), përdhunimi apo edhe prostitucioni idetyruar;

#### **– Dhuna sociale**

Kjo shfaqet në kontrollin e kontakteve me njerëzit e tjerë dhe në ndalimin e kontakteve, por gjithashtu në heqjen e lirisë në mënyrë të kundërligjshme. Nganjëherë autori, personat që i nënshtrohen dhunës i izolon nga familja dhe nga shoqet dhe shokët.

#### **– Dhuna financiare**

Qëllimi i kësaj forme të dhunës është krijimi i varësisë financiare. Autori ua ndalon personave që u nënshtrohen dhunës të punojnë dhe shqipton

ndalime të tilla apo e detyron të punojë për të. Kështu, është vetëm ai që kontrollon mjetet financiare.

## DHUNA SEKSUALE

Dhuna seksuale mund të jete pjesë e dhunës në familje por në fund të fundit, ajo është shumë më gjithëpërfshirëse. Fillon me një mënyrë të foluri që e zhvleftëson femrën. Shpesh ka shikime paturp apo ngacmime me gojë. Format e saj fillojnë nga *shkelje të kufijve* seksualë dhe ngacmime seksuale deri te përdhunimi dhe abuzimi seksual. Shpesh kufijtë midis formave të ndryshme nuk janë të qartë dhe munden të bashkohen.

Kjo formë e dhunës përdor seksualizmin si armë. Dhuna seksuale demonstroi pushtetin dhe mposht dhe nënshtron viktimën në të njëjtën kohë. Ka disa forma të dhunës seksuale. Munden të kryhen midis të rriturve. Nganjëherë të rriturit dhe të rinj kryejnë dhunë seksuale kundër fëmijëve apo edhe vetë fëmijët ushtrojnë dhunë kundër fëmijëve të tjerë. Viktimat

- **përdhunohen:** Autori fut penisin e tij apo sende brenda viktimës në forma të ndryshme, nganjëherë kjo behet nga persona të tjerë apo kafshë;
- **shtrëngohen të po marrin pjesë në aktivitete seksuale pa pëlqim:** Autori shtrëngon viktimën që ajo t'i plotësoje dëshirat seksuale atij apo dikujt tjetër në forma të ndryshme apo që ajo të masturbohet;

- **ngacmohen seksualisht:** Kundër vullnetit të personit të cenuar, autori iu prek gjinjtë ose prapnicën.

Krimet e përshkuara janë një keqpërdorim i rëndë i pushtetit. Autori i kryen krimet me qëllim dhe jo rastësisht. Ai dëshiron që dëshirat e tij seksuale të plotësohen apo që dinjteti i viktimës të cenohet. Këto veprime janë krime të dënueshme (janë krime të përcaktuara në kodin penal).

Ndërsa shkelje të kufijve seksuale nuk dënohen me ligj (nuk janë *krime/vepra penale*), por për to mund të bëhet një kallëzim penal.

**Viktima nuk duhet asnjëherë të ndihet fajtoare apo të qortojë veten. Nuk ka arsye për të pasur ndjenjë faji apo qortime të vetvetës! Faji nuk është i juaji, as pjesërisht. Ju nuk jeni në asnjë mënyrë përgjegjëse për veprime të dhunshme që kryhen kundër jush. Nuk keni nevojë të kuptoni apo madje shfajësoni sjelljen e autorit. (Nuk ka pse të keni mendime të tilla si p. sh.:**

**“Bëra gabim që shkova atje. Kam thënë diçka të gabuar. Ndoshta fundi ka qenë vërtet tepër i shkurtër.”)**

## SHKELJE TË KUFIJVE SEKSUALE

Shkelje të kufijve seksuale nganjëherë janë të paqëllimshme, shkaktohen shpesh nga padituria ose nga mungesa e ndjeshmërisë ose nga një ndjeshmëri të pamjaftueshme.

Shpesh, shkelje të kufijve seksuale janë fillimi i veprimeve seksuale të dënueshme me ligj. **Përvoja tregon, që viktimat shpesh nuk mund të mbrojnë veten. Ato e përjetojnë ngacmimin duke qenë të shokuar dhe kanë frikë. Prandaj brenda situatës shumë persona të cenuar nuk mund të luftojnë për veten. Sado, ato nuk kanë faj për këtë çfarë u ka ndodhur.**

**Thoni apo tregoni shumë qartësisht: “Ndal. Këtu është kufiri im.”**

## NGACMIMI SEKSUAL

Ngacmimi seksual ka për qëllim t’i ofendojë dhe të denigrojë një person tjetër (për veprimin gjinia e këtij personi është e përkatëse për veprimin). Prekja e bythës apo e gjirit mund të jetë një shembull për një ngacmim seksual.

Kjo është e rëndësishme gjithashtu në këtë rast: Thoni apo tregoni kryerësit qartësisht përmes fjalëve apo shenjave që



ai duhet te përfundoje ngacmime menjëherë. Kjo mund të parandalojë dhunën. Por kjo nuk funksionon gjithmonë. Në këtë rast mundeni të kërkoni ndihmë sepse disa fajtorë tejkalojnë kufijtë me qëllim!

## **ABUZIMI SEKSUAL**

Një forme e veçantë e dhunës seksuale është i ashtuquajtur i abuzimi seksual. Domethënë çdo veprim seksual nga ana e të rriturve me vajza dhe djem që ende nuk kanë mbushur 14 vjeç. Nuk ka rëndësi nëse këto vajza dhe këta djem duhen ta bëjnë këtë vullnetarisht (me pëlqim) apo jo.

Ka gjithashtu një formë tjetër të dhunës seksuale. Disa fëmijë (apo edhe disa të rrituri) janë me pak të fortë fizikisht, psikikisht, mendërisht sesa autori, apo për arsye te mungesës së njohurive gjuhësore. Nuk munden të bien dakord me dijeni të plotë. Kështu autori shfrytëzon pozitën e tij të pushtetit.

Ka autorë që kontaktojnë fëmijë dhe të rinj përmes strategjive të ndryshme (shpesh përmes internetit në "chat") për të përgatitur veprime të dhunshme seksuale. Në këtë rast, në fillim tregohet interes dhe pastaj, krijohet kështu një marrëdhënie. Autori mëson gjëra të ndryshme për personin tjetër dhe mund t'i përdorë gjithashtu për ushtrimin e presionit ("Do të njoftoj prindërit e tu nëse nuk më dërgon fotografi nudo.") Përgatitja e një vepre të dhunshme seksuale quhet "grooming".

### **Shembull:**

Një vajzë katërvjeçare. Të gjithë autorët ishin partnerë dhe dashnorë të nënës. Njëri nga autorët e ka zgjedhur nënën qëllimisht. Ajo ka kërkuar një partner përmes një reklame dhe ai ka vërejtur se ajo ka një vajzë të vogël. Ky partner kishte dëshirë të bënte seks me fëmijë dhe ai ka pasur mundësi ta sulmoje vajzën e vogël shumë lehtësisht sepse të gjithë kanë jetuar së bashku në një banesë. Nëna nuk ka ndërmarrë asgjë kundër veprimeve të dhunshme. Ajo ka pasur frikë se ai do ta braktiste.

Autori vepron me strategji dhe shfrytëzon struktura shoqërore, vlera dhe normativa të veçanta. Këtu bën pjesë edhe tabuja, të mos flitet për seksualitetin, sepse kjo shpesh i bën fëmijët dhe adoleshentët e cenuar të heshtin. Një faktor tjetër është edukata autoritare: Nëse fëmijët janë mësuar t'ua mos kthejnë fjalën të rriturve dhe të binden sipas urdhrat të tyre, atëherë ata e kanë më të vështirë të mbrojnë veten duke vendosur kufinj.

Abuzimi i fëmijëve mund të shkaktojë format e mëposhtme të presionit psikik:

### **– Turp:**

Fëmijët viktimë besojnë shpesh se dhuna është faji i tyre. Ndihen të turpëruar për atë që u ka ndodhur. Kjo ndjenjë është shumë shpesh më e fortë se zemërimi me autorin.

### **– Ndjenja e gabuar e përgjegjësisë:**

Fëmijët mendojnë se kanë bërë gabime apo se faji për prishjen e familjes është i tyre. Ky problem nuk është i zgjidhshëm për shumicën e fëmijëve që janë ekspozuar ndaj dhunës seksuale.

– **Frika nga probleme:**

Fëmijët bëhen gjithashtu viktima të dhunës seksuale në shkollë apo institucione të tjera. Megjithatë, ata nuk dëshirojnë të kenë probleme në familje, me mësuesit dhe me shoqe e shokë.

– **Gjykime:**

Fëmijët kanë frikë, që përjetimet e tyre të gjykohen ndryshe nga ana e njerëzve të tjerë dhe që ndjenjat e tyre të jenë gabim. Shpesh nuk i njohin të drejtat e veta dhe nuk e dinë, që i rrituri vepron në mënyrë të gabuar dhe që veprimi i tij dënohet me ligj.

– **Detyrimi për fshehtësi nga autori:**

Fëmijët kanë shumë vështirësi për të dalluar sekrete “të mira” dhe “të këqija”. Nganjëherë dëshirojnë ta zbulojnë një sekret, megjithëse autori ushtron presion.

**Shembull:**

Një baba e ka përdhunuar vajzën e vet dymbëdhjetë vjeçare për një kohë të gjatë. Vajza kishte dhimbje dhe ndjenjë, që babai bën diçka të gabuar. Babai i shpjegoi asaj, që ajo ishte më e bukur së mamaja dhe që ky si baba kishte detyrën t’ia tregonte asaj seksualitetin. Ajo ndjeu veten fajtoare ndaj mamasë dhe kuptoi, që mamaja largohej shpirtërisht nga ajo. Ajo besoi gjithashtu, që ajo e mban përgjegjësinë, që babait i erdhi epshi për të për shkak të pamjes së saj.

Vajza nuk gjeti dot përkrahje në familjen e vet. Por ajo kishte besim në mamanë e një shoqeje shkolle. Asaj mund t’i tregonte, çfarë përjeton në shtëpi. Kështu e ka marrë përkrahjen për t’u çliruar nga abuzimi.

Nëse fëmijët ndihen të respektuar nga mjedisi i tyre social, atëherë mësojnë, që mund t’u bësojnë ndjenjave të veta. Kështu më shpejt e gjejnë guximin të flasin me një person të besuar për abuzimin e përjetuar.

## **DHUNA SEKSUALE PËRMES LEDHATIMEVE TË SUGJERUARA**

Dhuna seksuale nuk përfshin gjithmonë “dhunë fizike” që shkakton dhimbje (për shembull të rrahurat). Në shumë raste, dhuna seksuale shfaqet edhe me anë të veprimeve, të cilat prezantohen si ledhatim, për shembull si përkëdhelje plot dashuri. Kjo lidhet me dominim dhe shtrëngim. Kjo formë e dhunës sjell për personat e cenuar një situatë të vështirë me dilemë: Bashkëshorti ose babai, gjyshi ose miku i familjes sugjeron, që ai dëshiron të bëjë diçka nga dashuria, por i tejkalon kufijtë fizike si dhe shpirtërore dhe shfaq pushtetin e vet. Personave të cenuar iu duket diçka e dhimbshme dhe e shëmtuar. Përmes shpjegimeve si “ti je kaq joshëse ose nëse ti nuk do të visheshe në mënyrë kaq tërheqëse ... Mamaja jote thjeshtë nuk është kaq e mirë si ti” ... ose “Po shoh, si reagon trupi yt, edhe ti e dëshiron ...”, autori do, që t’ua fusë personave të cenuar ndjenjën, që ata marrin pjesë vullnetarisht. Ai iu fut fëmijës mendimin, që ky të ishte vetë fajtor për zhvillimin e veprimeve seksuale të dhunshme. Ka edhe gra, që e përjetojnë këtë shtyrje të përgjegjësisë për veprën.

Personat që u nënshtrohen dhunës seksuale nganjëherë ndjejnë gjithashtu kënaqësi seksuale deri në orgazëm. Kjo është veçanërisht e keqe për ta. Por trupi reagon vetëm ndaj stimullit seksual. Nuk është e nevojshme për t'u ndjerë më pas të turpëruar!

#### **Situata ligjore:**

Veprime seksuale ndaj ose me fëmijë nën moshën katërmëdhjetë vjeç janë gjithmonë të dënueshme.

Neni 176 i Kodit Penal i Gjermanisë përcakton qartë: përbën gjithashtu abuzim seksual nëse fëmijët detyrohen të bëjnë veprime seksuale me autorin apo autorët, apo me dikë tjetër. Një tjetër variant i rëndësishëm i krimit është t'u tregohet pornografi fëmijëve dhe të ndikohet ndaj tyre në këtë mënyrë.

Kodi penal mbron të rinjtë deri në moshën 18 vjeç nga sulmet e bëra nga ana e personave që kanë një marrëdhënie të ashtuquajtur kujdestarie. Këta persona janë prindërit (edhe njerku apo njerka), mësuesit, trajneri i arsimit profesional, punonjësit social dhe nëpunës të tjerë në institucionet e arsimit dhe edukimit dhe në zyrën për mbrojtjen e të rinjve. Megjithatë, në këtë moshë kontrollohet shkalla e detyrimit, shtrëngimit apo presionit që është ushtruar ndaj të rinjve dhe nëse është shfrytëzuar një varësi e tillë.

Dënime parashikohen edhe për të mitur (14 deri 18 vjeç) dhe të rinj (18 deri 21 vjeç), nëse shfrytëzojnë gjendjen e vështirë të një vajze/djali apo paguajnë me para për veprime seksuale [siç].

## **PASOJAT E DHUNËS KUNDËR FEMRAVE DHE FËMIJËVE**

### **PASOJAT PERSONALE**

Çdo person reagon në mënyrë të ndryshme ndaj dhunës. Por përjetime me dhunën specifike seksuale janë gjithmonë një cenim masiv i integritetit të tyre për të gjithë persona që janë ekspozuar ndaj dhunës. Kjo mund të shkaktojë një *traumë* psikike afatgjatë.

Shumë gra dhe fëmijë që i janë nënshtuar dhunës seksuale e ndjejnë veten fajtorë dhe vuajnë shumë gjatë gjithë jetës. Ata kërkojnë të kuptojnë dhe klasifikojnë çka ka ndodhur dhe të kenë përsëri kontroll mbi veten dhe jetën e tyre. Nëse provojnë ta kuptojnë ngjarjen, normalisht, u shkakton ndjenja faji. Ata mendojnë se sjellja e tyre ka një lidhje me veprimet e dhunshme.

#### **Shembull:**

“Ah sikur të mos kisha shkuar në këtë vend, ose pse nuk fjeta me të vullnetarisht. Duhet ta pranoj se është burri im dhe sa ka të drejtën të flejë me mua.”

Femrat që janë ekspozuar ndaj dhunës ndjehen të shumë të tronditura pas krimit. Nuk e ndjejnë vetën dhe mjedisin përreth, nganjëherë, për ditë të tëra. Ndjehen të huaja në mjedisin ku janë mësuar dhe kanë ndjenjën se çdo për të cilën kanë besuar deri në atë kohë nuk ekziston më. Në këtë situatë ndjehen të çorientuara.

Sjellja e palës së dëmtuar pas krimit varet nga persona individualë dhe mund të jetë shumë e ndryshme. Nuk ka shembuj „tipikë“. Femrat mund të reagojnë si më poshtë dhe/apo mund të përjetojnë pasojat e mëposhtme:

– **Paraqitja e padisë:**

Disa femra mendojnë të bëjnë denoncim në polici pas krimit.

– **Kërkimi i kontaktit:**

Femra të tjera kërkojnë të flasim me persona referues, të shkojnë në qendra konsulente, ose të bisedojnë me njerëz të cilëve u besojnë.

– **Kolapsi:**

Shumë viktime qajnë për ora, por nuk mundin të flasin dhe tregojnë dëshpërimin e tyre krejt qartësisht.

– **Kontrolli:**

Viktima të tjera duken të kontrolluara, të mbledhura, të ekuilibruara dhe të buta. E kanë krejt të qartë se i kanë mbijetuar dhunës dhe se autori ka kryer një padrejtësi por, megjithatë, pyesin veten se çfarë gabimesh kanë bërë.

– **Kërkimi i shfajësimeve:**

Disa viktime nuk e konsiderojnë ngjarjen që ka ndodhur absolutisht si të dhunshme. Provojnë t’i klasifikojnë, t’i shfajësojnë dhe të konsiderojnë veprimet e dhunshme si diçka “normale”. Këto femra shpesh nuk mundin t’u besojnë ndjenjave të tyre personale. Nuk kanë mësuar të pranojnë ndjenja të tilla si atë të neveritjes, frikës, dëshpërimit, urrejtjes, *pikëllimit dhe pafuqisë*.

– **Vetëndergjegje dhe vetëbesim i çrregulluar:**

Dinjteti, trajtim normal i seksualizmit dhe ndjenja për trupin vete mund të çrregullohen për një kohë të gjatë.

– **Vetëqortime:**

Shumë femra reagojnë me turp dhe neveritje ndaj vetes ose vuajnë nga vetëqortime dhe ndjenja faji.

– **Iritime emocionale:**

Shumë viktime të dhunës janë krejt të irituar nga reagimet të tyre gjatë krimit.

Shpesh të afërmit i përforcojnë të gjitha këto ndjenja. Pjesëtarët e familjes, shoqet dhe shokët dhe persona të njohur shpesh nuk e kuptojnë apo besojnë çka ka ndodhur dhe fajësojnë personat që janë prekur nga dhuna.

**Shembull:**

Vajza katërvjeçare është rritur në një mjedis të veçantë ku dhuna seksuale është konsideruar si diçka “normale”. Nëna nuk ka as vullnetin, as mundësinë për ta mbrojtur fëmijën. Ajo nuk ka mundur të kërkojnë ndihmë, pasi nuk e ka ditur se e bija ka pasur nevojë për ndihmë. Ajo ka humbur ndjenjën për trupin e saj, ka humbur besimin në vetvete dhe e ka konsideruar trupin e saj të neveritshëm. Së fundi, ka filluar të mos lahet më. Njëkohësisht, ka dëshiruar dhurimin. Kishte mësuar se dhurimi merret nëpërmjet seksit dhe ua ka mbushur mendjen shokëve të shkollës të kryejnë veprime seksuale me të. Kjo sjellje është vërejtur dhe konsideruar si sjellje e seksualizuar. Ky ishte një shkak për t’u konsultuar me një specialiste.



## **PASOJA SHËNDETËSORE**

Shpeshherë, pasojat shëndetësore të përjetimeve të dhunshme nuk mund të lidhen qartësisht me dhunën. Disa probleme psikike apo *psikosomatike* ndodhin vetëm më vonë dhe zgjasin për një kohë të gjatë.

Femrat, që kanë përjetuar dhunë si fëmijë dhe që tani vuajnë pasoja afatgjate, shpesh nuk janë në gjendje t'i klasifikojnë problemet e tyre menjëherë si pasojë e përjetimeve të dhunshme.

Përveç kësaj, shpesh ndodh që viktimat thonë që lëndimet janë vetëm si pasojë e "aksidenteve".

Simptomat e mëposhtme mund të jenë pasoja të përjetimeve të dhunshme:

### **– Dëmtime fizike:**

Fraktura të kockave, dëmtime të organeve të brendshme, dëmtime të trurit si pasojë e goditjeve në kokë, shenja që nuk janë shëruar në të gjithë trupin, djegie, gërryerje, deformime në fytyrë, më pak aftësi për të parë dhe dëgjuar, lëndime të baqthit si pasojë e shkelmimeve dhe goditjeve ose aborte të detyruara.

### **– Plagosje në zonën intime:**

Përdhunimet shkaktojnë plagosje dhe hemorragji anale dhe vagjinale, infeksione të fshikëzës, sëmundje seksuale të transmetuese, sterilitet dhe dështime.

### **– Sëmundje psikosomatike:**

Ulcera të stomakut, tromboza, dhimbje të zemrës, dhimbje koke të vazhdueshme, çrregullime të qarkullimit të gjakut dhe shumë sëmundje të tjera.

### **– Dëmtime psikike:**

Frika dhe ankthe, vështirësi gjumi, mosbesim, *depresione*, ndjenja turpi dhe faji, *çrregullime të stresit post-traumatik*, përfytyrime të traumës, ndjenja të ndotjes dhe *stigmatizimi*, çrregullime të identitetit dhe në caktimin e kufijve, vetëndërgjegje dhe vetëbesim i ulët, dëshpërime, vetëlëndime, dhimbje të vazhdueshme gjatë seksit, sjellje të fortë seksuale, çrregullime në të ngrënë, akte të sëmurë, varësi nga droga dhe alkooli, vetëvrasje ose tentativa për vetëvrasje.

Nganjëherë, të mbijetuarit nuk i lidhin pasojat psikike me përjetimet e dhunshme. Ata nuk i konsiderojnë problemet e tyre si pasojë të keqtrajtimit, por si "pamjaftueshmëri" të vetvetes. Shpesh, një gjë e tillë e zvogëlon edhe më shumë vetëndërgjegjen dhe vetëbesimin.

## PASOJAT FAMILJARE DHE SOCIALE

Njerëzit si qenie shoqërore varen nga rrjetet e tyre, si për shembull familja, shoqet dhe shokët, apo kolegët e punës. Mirëpo, përjetime të dhunës së drejtpërdrejtë ndodhin, kryesisht, në mjedisin e njohur – autorët janë vetëm rrallë njerëz të panjohur– dhe kështu vetë mjedisi social është i prekur drejtpërdrejt nga dhuna. Shumë femra që u janë nënshtruar dhunës e kanë të vështirë të flasin për veprimin e dhunshëm që kanë mbijetuar. Kanë frikë nga kritika të ashpra (si p.sh. “Pse ke shkuar atje?!” apo “Patjetër ke flirtuar me ta?”). Nga ana tjetër, shumë të afërm, shoqe dhe shokë të viktimave të dhunës e kanë të vështirë ta pranojnë se dhuna ka ndodhur në mjedisin e tyre.

Pasoja nga të cilat rrezikohen persona që janë ekspozuar ndaj dhunës në familje apos asaj seksuale:

### – Frika nga izolimi dhe përjashtimi brenda mjedisit social:

Përhapja e përjetimeve të tyre të dhunshme mund të rezultojë në ndarjen nga partneri, vetmi, ndarje nga familja dhe në frikë nga marrëdhënie (të reja) intime.

### – Ndjenja e fortë e izolimit:

Kur keqtrajtime zgjasin për një kohë të gjatë, fillon një izolim mjaft i fortë nga mjedisi. Pasojë të tij janë tërheqje e fortë në vetvete dhe veçanërisht ndryshime të sistemit të vlerave.



– **Varësitë ekonomike në fillim, nuk krijojnë asnjë rrugëdalje:**

Kjo sjell një ndjenjë të fortë izolimi. Viktimat kanë jo vetëm frikë nga sjellja e dhunshme e autorit, por edhe ndjenja se nuk mund të jetojnë pa të.

– **Pasiviteti:**

Humbja e vetëndërgjegjes dhe vetë-besimit shpesh çon në një përshtatje totale me autorin. Kjo lidhet me mbijetesën. Lidhja midis autorit dhe viktimës bëhet aq fortë, saqë femra e prekur nga dhuna e sheh veten gjithnjë e më shumë në mënyrën që autori e ka bindur se ajo “është”.

– **Asnjë përgjegjësi ndaj fëmijëve:**

Jo rrallë, femrat që i nënshtrohen dhunës së muren nga çrregullime të rënda psikike (*çrregullime të stresit posttraumatik, çrregullime të personalitetit, të shkëputjes nga identiteti*) dhe si pasojë i lënë pas dorë fëmijët e tyre.

– **Frika nga ndryshimi:**

Koncepte të jetës dhe situatat e punës mund të ndryshojnë si pasojë e një ndarjeje; për shembull, përmes pushimit nga puna ose ndryshimit të vendit të punës, problemeve në punë, papunësia.

– **Varfëria:**

Si rezultat i ndarjes shumë femra varfërohen më shumë apo rrezikohen më shumë nga varfëria. Ka edhe raste që humbasin banesën dhe bëhen të pastrehë. Femrat dhe fëmijët që humbasin rrjetin e tyre social pas përjetimit të dhunës, rrezikohen në masa ekstreme nga varfëria.

Personat që kanë mbijetuar ndaj dhunës nuk vuajnë vetëm nga *izolimi* social. Shumë femra ikin në një qendër strehimi për gra dhe lënë jo vetëm mjedisin e tyre

në të cilin janë mësuar, por edhe pronën e tyre. Shpesh heqin dorë nga *denoncimet*, ndihma financiare për mirëmbajtje ose zhdëmtimi.

Arsyet për këtë janë:

- Frika nga përsëritja e sulmeve të dhunshme;
- Turpi, sepse mendojnë në shumicën e rasteve se faji është (edhe) i tyre dhe se nuk duan ta turpërojnë familjen e tyre
- Dijenia se rruga përmes sistemit të drejtësisë është e vështirë dhe jo gjithmonë e suksesshme.
- Përvojat ku konsiderohet që burrat kanë “të drejtë” të rrahin dhe dënojnë femrat dhe fëmijët dhe të urdhërojnë kryerjen e veprimeve seksuale nga ana e bashkëshortes.

## PASOJA QË TEJKALOJNË BREZA

Njerëzit, të cilët kanë përjetuar dhunë në fëmijëri, më vonë bëhen vetë autorë të dhunës ose qëndrojnë në një “rol të viktimës”.

### Shembull:

Nëna e një vajze katër vjeç ka përjetuar në fëmijërinë e saj vetë dhunë seksuale nga i ati. Si nënë, ajo nuk ishte e aftë ta mbrojtë vetën dhe të bijën. Përkundrazi, ajo ishte mësuar të lidhej me burrat përmes seksit. Një gjë të tillë, e bija e ka marrë përsipër në moshën dymbëdhjetëvjeçare. Asistentja e familjes ka pyetur pse nëna nuk e kishte mbrojtur të bijën nga sulmet e partnerit. Nëna i ishte përgjigjur: “Kjo ishte për mua normale – edhe unë kështu e kam përjetuar.”

## PASOJA PËR FËMIJË

Fëmijët që përjetojnë dhunë familjare, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vuajnë nga *dëmtime* psikike të tilla si pasoja të vetë personit të prekur dhe shpesh janë shumë të traumatizuara.

Pasojat janë:

– **Vetëndërgjegjja dhe vetëbesimi zvogëlohen:**

Vetërealizimi kufizohet së tepërmi.

– **Zhgënjimi:**

Kur përjetohen dobësi dhe pafuqi të një prindi, pafuqia e vet mund të forcohet.

– **Vlerësime të gabuara:**

Por kur përjetohen dobësi dhe pafuqi të një prindi, kjo mund të shkaktojë gjithashtu që fëmijët të qëndrojnë në anën e autorit, sepse ndihen me të sigurt atje.

– **Modele të pasigurta:**

Fëmijët që kanë përjetuar dhunë në familje, shpesh bëhen vetë autorë të dhunës ose viktimë.

– **Dëmtime fizike:**

Në shumicën e rasteve fëmijët vuajnë nga dëmtime të rënda psikike të ngjashme me ato të nënës, përfshirë lëndime fizike. Nganjëherë dëshirojnë të ndihmojnë nënën. Më vonë bëhen edhe ata viktimë të drejtpërdrejta të veprimeve të dhunës.

– **Ngarkesa e bartësit të sekretit:**

Shpesh fëmijët duhet të vazhdojnë të mbajnë kontakte me jashtë, sepse duhet që shkojnë në shkollë. Në kontekstin e dhunës në familje, shpesh ushtrohet presion ndaj tyre. Kanë frikë se babai do të futet në burg sepse nuk ishin në gjendje ta mbanin gojën mbyllur.

I bindin se është faji i tyre nëse familja ndahet si rezultat i një ndërhyrjeje të policisë. I kërcënojnë se do t'i çojnë në shtëpinë e fëmijës. Kjo është arsyeja pse, në të shumtën e rasteve, fëmijët nuk flasin për përjetimet në shtëpi. Përveç kësaj, mësuesit në shumë shkolla nuk mund ta trajtojnë në mënyrën e përshtatshme dhunën e supozuar.

– **Trauma të rënda:**

Shtypja dhe shuarja e përjetimeve mund të shkaktojnë përjashtimin social, por madje edhe vetëvrasje.

– **Shkaqet nga ndryshimet:**

Shumë fëmijë braktisin familjet dhe marrin guximin të nisin një jetë të re.

**Shkoni te persona, të cilëve u besoni, flisni me ta dhe me qendrat e specializuara të konsulcës për përkatje dhe mbrojtje për fëmijë që përjetojnë dhunë në familje.**



## 4. Rrugëdalje nga dhuna

### MBROJTJA LIGJORE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË GJERMANI

**Fëmijët, femrat dhe meshkujt kanë të drejta të barabarta në Gjermani. Për këtë arsye mundësitë e mbrojtjes janë të barabarta për të gjithë.**

Në Gjermani ka mundësi të ndryshme mbrojtjeje për viktimat e dhunës. Çdo person gëzon të drejtën për një jetë pa dhunë.

Ka shumë aspekte të mundshme të dhunës nga ana e partnerit: Fyerje, kufizime të lirisë personale, kontrolli, agresione, kanosje dhe kërcënime, rrahja, seks i detyruar, ndjekje apo ngacmime.

### NDIHMA NË RAST NEVOJE

Nëse partneri kryen dhunë, **policia** mund të thirret në **110**. Ka edhe mundësi të shkonit te stacioni i policisë. Policia është e detyruar të vijë menjëherë në mbrojtje të personit. Policia mund ta nxjerrë personin jashtë banesës për një kohë që zgjat 14 ditë dhe ta arrestojë autorin për të zbatuar dëbimin nga banesa. Nëse është kryer një vepër penale, policia duhet të pranojë denoncimin.

Femrat që kanë mbijetuar dhunë mund t'i drejtohen, gjithashtu, qendrave të strehimit për femrat, ku mund të gjejnë strehim të përkohshëm. Është shumë e

rëndësishme që lëndimet të kontrollohen dhe dokumentohen nga mjekja.

**Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Femrat dhe fëmijët kanë të drejta të barabarta me meshkujt dhe kanë të drejtë të vendosin vetë. Ligji dhe feja janë të ndarë.**

### MUNDËSITË E KËSHILLIMIT

Femrat e ekspozuara ndaj dhunës, përkrahen, ndihmohen dhe këshillohen në lidhje me mundësi të tjera mbrojtjeje nga qendra e konsulencës, qendra e strehimit për femra, zyra për ndihmë ndaj viktimave apo qendra për përkrahjen e femrave në krizë (shih adresat e kontaktit). Qendrat e specializuara të konsulencës japin informacione për sa i përket hapave të mëtejshme edhe pa njoftuar policinë dhe pa paraqitur një *padi penale*, e cila mund të paraqitet edhe më vonë. Sipas dëshirës, është i mundur të jepet konsulencë anonime.

Femrat që janë prekur nga dhuna mund të kërkojnë, gjithashtu ndihmën e shoqeve dhe shokëve, të afërmeve ose fqinjëve.

Nëse planifikohet të bëhet një denoncim në polici, përkrahja e avokatit/avokates është e domosdoshme.

**Punonjësit e qendrave të specializuara të konsulencës, mjeket dhe avokatet kanë në parim detyrimin e ruajtjes së sekretit. Megjithatë, nëse mirëqenia e një fëmije mund të rrezikohet, ato mund të jenë të detyruara të kontaktojnë entin për mbrojtjen e të rinjve.**

## **URDHRA MBROJTJE NË PËRPTHJE ME LIGJIN PËR MBROJTJEN NGA DHUNA**

“Kush rreh, duhet të largohet!” – Ligji mbron çdo person të prekur nga dhuna, ngacmimet dhe ndjekja.

Kush është bërë viktimë e dhunës, kanosjes apo ndjekjeve mund të aplikojë, pavarësisht nga *procedura penale*, për një urdhër mbrojtjeje pranë gjykatës civile. Qendrat e konsulencës kundër dhunës mund t’i mbrojnë falas personat që kanë përjetuar dhunë. Masat e gjykatave në përputhje me ligjin për mbrojtjen nga dhuna (*Gewaltschutzgesetz, GSG*) kushtojnë para. Por ka *ndihmë ligjore për procedurën ligjore* për persona që kane nevojë për të, sepse nuk kane të ardhura [sic] apo pasuri.

Çdo person mund të aplikojë për një urdhër mbrojtjeje pranë gjykatës për çështjet familjare (gjykatat e qarkut të shkallës së parë) në vendbanimin, në vendin ku është kryer vepra, ose në vendin e qëndrimit.

Si masa mbrojtëse, gjykata mund të ndalojë, për shembull:

- që autori t’i afrohet banesës,
- që ai të qëndrojë në vende ku femrat që kane mbijetuar dhunë (duhen të shkojnë rregullisht,
- që autori të marrë kontakt,
- apo që ai të takohet me të.

Personat që jetojnë së bashku me autorin në një banesë, mund të kërkojnë, gjithashtu, që autori të largohet nga banesa.

Masat mbrojtëse caktohen nga gjykata për një kohë të caktuar dhe policia vihet në dijeni për to. Nëse autori shkel urdhrat e mbrojtjes së gjykatës, ai kryen një vepër penale. Edhe në këtë rast mund të lajmërohet me telefon policia.

## **KONSULTIMI ME NJË AVOKATE**

Përfaqësimi nga avokatja, në fakt, nuk kërkohet me ligj, por kur dikush dëshiron të paraqesë një padi penale, përkrahja nga avokatja apo avokati është shumë e domosdoshme, sepse vetëm kështu ka mundësi që procedura të ndikohet. Pastaj, femrat që u janë nënshtruar dhunës paraqiten në gjykatë si bashkëpaditëse. Avokate që kanë shumë përvojë profesionale mund të rekomandohen nga qendra e konsulencës kundër dhunës, apo nga institucioni i mbështetjes.



Personat që nuk kanë para të mjaftueshme për këshillimin nga avokatja apo avokati, kanë mundësinë të aplikojnë për *ndihmë ligjore për rrugën jashtëgjyqësore*. Vërtetimi për të drejtën për ndihmë ligjore në rrugë jashtëgjyqësore mund të merret pranë gjykatës së qarkut në vendbanim. Gjatë aplikimit, femrat që kanë përjetuar dhunë mund të përkrahen nga qendra e konsulencës kundër dhunës.

Personat që janë bërë viktimë e një krimi dhe duhet të gjykohen si dëshmitarë në procesin gjyqësor, mund të aplikojnë, gjithashtu, për një vërtetim për të drejtën për ndihmë ligjore për rrugë jashtëgjyqësore për këshillimin e parë.

Femrat që kanë i kanë mbijetuar dhunës mund të paraqiten në gjykatë si bashkëpaditëse dhe të marrin një avokate për t'i përfaqësuar si bashkëpaditëse. Shpenzimet mund të barten në bazë të rregullave të caktuara. Lejohet të pyesni se sa kushton një përfaqësim si bashkëpaditëse gjatë një këshillimi të parë tek avokati apo avokatja, apo të qendra e konsulencës kundër dhunës.

Edhe gjatë marrjes në pyetje si dëshmitar rekomandohet të merret një avokate për të *përkrahur dëshmitaren*. Në bazë të rregullave të caktuara, mund të barten edhe shpenzimet për këtë qëllim.

## MUNDËSI TË TJERA PËRKRAHJEJE

Përkrahje ka jo vetëm nga ana e qendrave të konsulencës, avokateve apo qendrave të strehimit të femrave. Gjithashtu, mund të aplikohet më herët që *një person i besuar mund t'ju* shoqërojë gjatë marrjes në pyetje.

Femrat që kanë mbijetuar ndaj dhunës mund të përdorin edhe shoqërim psikosocial në proces. Shoqërueset psikosociale të procesit janë të trajnuara në mënyrë të veçantë dhe përkrahin dëshmitare që janë gjithashtu viktima dhe të afërmit e tyre në mënyrë gjithëpërfshirëse para, gjatë dhe pas procedurës penale. Shoqërimi psikosocial në jetën e përditshme bëhet nga asistente të trajnuara që punojnë në qendra konsulence të specializuara për të siguruar që procedura penale dhe përkrahja në jetën e përditshme ndahen qartësisht dhe se shoqëruesit në gjyq nuk mund të akuzohen që ta ndikojnë dëshmitaren/viktimën te gjykata.

**Që prej janarit 2017 do të zbatohet e drejta për shoqërim social në gjykatë.**

## **ÇFARË NDODH PAS PARAQITJES SË PADISË PENALE NË POLICI?**

Deklarata e femrës që i është nënshtruar dhënës është shumë e domosdoshme në rastin e *padisë penale* pas dhunës në familje apo dhunës seksuale, sepse kryesisht nuk ka prova të tjera ose ato kanë vetëm një rol plotësues. Vetëm në raste shumë të rralla ka dëshmitarë okularë.

Kush vendos të paraqesë një padi penale në polici, duhet ta ketë që qartë se ajo duhet të japë disa herë deklaratën e saj (p.sh. në polici **dhe** në gjykatë) hollësisht në lidhje me ngjarjen e krimit. Kjo mund të shkaktojë shumë stres dhe një ngarkesë të madhe. Për t'u përgatitur për këtë është e rëndësishme të shkoni, në fillim, te qendra e konsulencës së specializuar.

Femrat që i kanë mbijetuar dhunës mund të përkrahen plotësisht nga shoqërujesja psikosociale në gjyq.

Disa femra që janë ekspozuar ndaj dhunës nuk janë të gatshme në asnjë mënyrë që të paraqesin një padi penale, ato mohojnë qëllimisht veprimin e dhunshëm për të cilin është ngritur padi penale, apo mohojnë veprimin e dhunshëm. Kjo ndodh ndoshta sepse ekziston frika për më shumë dhunë të re, ose sepse viktimat nuk shohin një rrugëdalje të mundshme nga marrëdhënia me autorin. Nëse dikush nuk dëshiron të bëjë padi penale, patjetër ka një arsye për këtë. Për ndihmë dhe këshillim në lidhje me këto dhe çështje të tjera mund t'i gjeni në qendrat e specializuara të konsulencës, edhe pa paraqitur një padi penale.



## **MBROJTJA E FEMRAVE QË I KANË MBIJETUAR DHUNËS**

Kur është paraqitur padi penale, policia shpesh bën me autorin një të ashtuquajturën bisedë për parandalimin e shkaktarëve të rreziqeve: Policia i sqaron autorit krejt qartës se ai nuk duhet të kontaktojë me viktimën dhe se nuk duhet të kryejë sërish veprime të dhunshme. Kjo u bën përshtypje shumë autorëve dhe ndihmon ata të pengohen. Është e rëndësishme që femrat që rrezikohen nga më shumë dhunë të njoftojnë policinë, nëse ka marrje kontakti ose përpjekje për të ndikuar (edhe nga ana e të afërmeve dhe shokëve dhe shoqeve të autorit). Vetëm kështu policia mund të ndihmojë!

## **KONTAKTI ME POLICINË**

Në shume stacione policie ka oficerë policie që janë të trajnuara posaçërisht për punën me viktimat e dhunës. Avokatja ose një person tjetër i besueshëm mund të vijë me ju gjatë marrjes në pyetje. Nëse ka probleme gjuhësore, kërkoni nga policia që të sjellë një përkthyes profesionit.

Lajmërimi i autoriteteve hetimore në raste penale, si policia, bën që ato të marrin masa hetimi.

Nëse femra që i është nënshtruar dhunës, gjatë procedurës, vendos të mos e bëjë deklaratën e saj, një gjë e tillë është e mundur vetëm në rastet kur ajo ka të drejtën të refuzojë dëshminë për të mos inkriminuar veten ose të afërmit në një deklaratë të vërtetë.

## **PROCEDURA TË MËTEJSHME**

Nëse prokuroria ngre një padi ndaj autorit dhe nis një procedurë gjyqësore, edhe një herë kjo përbën një ngarkesë për personin e ekspozuar ndaj dhunës. Një përgatitje e mirë, një qendër e specializuar konsulente, një shoqëruese psikosociale në gjyq apo një avokate mund të ndihmojë shumë për largimin e frikës.

Rruga për të paraqitur një padi penale nuk është e lehtë. Prandaj është shumë e domosdoshme të informoheni mirë para zhvillimit të procedurës dhe për të drejtat që keni në procedurë dhe për masat e mundshme për mbrojtjen e viktimës dhe shoqërimin në gjyq.

**Një padi penale nuk mund të tërhiqet.**

## **PAGESA PËR SHËRIMIN, PENSIONE DHE PAGESA PËR KUJDESEN PËR MIRËQENIEN**

Nëse një person mund të në një farë mase që vuan nga dëmtime shëndetësore për arsye të një sulmi të paligjshëm të kryer me qëllim, ajo ka të drejtën për të marrë ndihmë nga shteti për shkak të dëmtimeve shëndetësore dhe ekonomike. Personat që nuk kanë mbushur ende tre vjet qëndrimi në Gjermani kanë vetëm të drejtë për ndihmë të pavarur nga të ardhurat.

Përfitimet e mëposhtme mund të financohen *përmes ligjit për kompensimin e viktimave (OEG)*:

- Trajtime për shërimin dhe mjekimin (*gjithashtu psikoterapi*)
- *Pagesa të pensioneve* (që varen nga shkalla e dëmtimeve që janë pasoja dhe ndoshta edhe nga te ardhurat)
- *Pagesa për përkujdesjen për mirëqenien*: Në nevojë ndihma të veçanta në rastin individual (për shembull për pjesëmarrjen në punë, për përkujdesjen për të sëmurët, për vazhdimin e punëve të shtëpisë dhe në mënyrën plotësuese për jetesën)
- *Masa për rehabilitimin* (për shembull qëndrime në sanatorium)

## **SË BASHKU TË ÇLIRUARA NGA DHUNA**

Tashmë në qendrat e specializuara të konsulencës përkrahet shumë *vetëmbrojtja* që femrat të mund të jetojnë të çliuara nga dhuna. Aty bisedohet në mënyrë të barabartë dhe bisedat kanë për qëllim rritjen e vetëndërgjegjes dhe vetëbesimit të femrave që i kanë mbijetuar dhunës. Ato mësojnë ku mund të gjenden shanse dhe pengesa për zhvillime të mëtejshme.

Por, ju mësoni, gjithashtu, që duhet të bëheni aktive dhe si të bëheni të tilla dhe si ta mbronin veten dhe si mund ta bëni këtë dhe gjithashtu se një femër që ka i mbijetuar dhunës ka potencialin ta çlirojë veten nga dhuna. Forcimi i femrave (veçanërisht i të drejtave dhe mundësive të tyre për vetërealizim), por edhe forcimi i meshkujve që të jenë të vetëdijshëm për të mënyrën se si mund të veprojnë pa ushtruar dhunë edhe në situata të vështira

**Përjetimi i dhunës nuk do të thotë se femrat që kanë qenë të abuzuara duhet të qëndrojnë viktimë për gjithë jetën – ka rrugëdalja nga dhuna.**

# Fjalorth

<b>Abuzimi</b>	Shfrytëzimi ekstrem i një personi. Veprime seksuale ndaj dhe me fëmijë që nuk janë të aftë të mbrohen. (persona në nevojë, të burgosur, etj.)
<b>Avokatja</b>	Përfaqësuesja dhe konsulentja në të gjitha çështjet ligjore. Avokatet kanë të drejtën të refuzojnë të dëshmojnë kundër klientëve të tyre dhe ato kanë gjithashtu detyrimin për ruajtjen e sekretit. Kjo mbron marrëdhënien e besimit midis avokates dhe klientës
<b>Barazi/me të drejta të barabarta</b>	Siguria e të drejtave dhe privilegjeve të barabarta. Të drejta të barabarta sipas ligjeve dhe trajtimi i barabartë pavarësisht nga gjinia, mosha, origjina apo feja e të tjera
<b>Cenimi i dinjitetit</b>	Veprime që e kanë për qëllim fyerjen apo poshtërimin e një personi tjetër
<b>Çrregullim shkëputjeje të identitetit</b>	Çrregullime të thella të personalitetit që janë shkaktuar nga ngjarje traumatike. Në këtë rast, ekzistojnë dy apo më shumë personalitet të ndryshme brenda një personi
<b>Çrregullime të stresit posttraumatik</b>	Sëmundje psikike pas përjetimeve ekstreme apo të rrezikshme për jetën (trauma)
<b>Çrregullimi kufitar i personalitetit</b>	Çrregullim i personalitetit që karakterizohet nga paqëndrueshmëria për sa i përket marrëdhënieve ndërpersonale, gjendjes shpirtërore dhe imazhin për vetveten
<b>Denoncime/padia penale</b>	Lajmërimi i policisë apo prokurorisë që është kryer një vepër penale. Kushdo mund të paraqesë një padi penale
<b>Depresioni</b>	Sëmundje psikike që karakterizohet nga kapacitete të reduktuar, gjendje shpirtërore të dëshpëruar, humbje e interesit dhe mungesa e motivimit. Ka formësime të ndryshme
<b>Detyrimi i ruajtjes së sekretit</b>	Detyrimi ligjor që ndalon grupe të ndryshme profesionale të transmetojnë informacione të palë të treta
<b>Dëbimi masiv</b>	Dëbimi i detyrueshëm i popullsisë që banon diku apo grupeve të popullsisë dhe dërgimi i tyre në një shtet tjetër
<b>Dominimi</b>	Marrëdhënie gjatë së cilës një person ka rolin udhëheqës dhe kështu është epror
<b>Drejtësia, sistemi i drejtësisë</b>	Tërësia e autoriteteve gjyqësore që janë përgjegjëse për zbatimin e të drejtave
<b>Dhuna gjinore</b>	Dhuna kundër personave për shkak të gjinisë së tyre

<b>Dhuna psikike</b>	Një formë e dhunës ku personat që i nënshtrohen dëmtohen emocionalisht nga kërcënime të drejtpërdrejta psikike, fyerje dhe ofendime apo kanosje dhe kontrolli
<b>Institucione të arsimit</b>	Institucione që janë urdhëruar nga rregullore të shtetit apo të komunës që të ofrojnë arsim, përfshirë shkolla dhe kopsht fëmijësh, por edhe institucione të tilla si biblioteka, muze dhe shoqata interesi
<b>Integriteti</b>	Përputhja e vlerave (personale) me mjedisin
<b>Izolimi</b>	Vetmia/përrjashtimi i një personi
<b>komunikoj</b>	shkëmbej/transmetoj informacione
<b>Krime, vepra penale</b>	Veprime që shkelin ligjet ekzistuese
<b>Ligji për kompensimin e viktimave (OEG)</b>	Ligji për rregullimin e kompensimit dhe përkujdesjes për viktimat e dhunës dhe për vejushat dhe vejanët, jetimët apo prindërit e personave të vararë, që kanë vdekur nga dhuna
<b>Ligji për mbrojtjen nga dhuna (GSG)</b>	Ligji për rregullimin e masave për mbrojtje për viktimat e dhunës sipas së drejtës civile
<b>Marrëdhënie kujdestarie</b>	Marrëdhënie në të cilën një person përkrahet ose kujdeset nga një person tjetër (për shembull fëmijët përkrahen nga mësuesit)
<b>Marrëdhënie varësie</b>	Marrëdhënia në të cilën dikush varet nga një person tjetër (p.sh. në mënyrë financiare ose emocionale)
<b>Masa për rehabilitimin</b>	Riintegrimi në shoqëri i një personi të sëmurë fizikisht/psiqikisht
<b>Mirëqenia e fëmijës</b>	Gjendja në të cilën një fëmijë ndjehet mirë
<b>Mundësi reagimi</b>	Mënyra e sjelljes dhe e reagimit në situata të ndryshme
<b>Ndihma ligjore në rrugë jashtëgjyqësore</b>	Një pagesë sociale për t'u bërë të mundur njerëzve me të ardhura të ulëta apo pa të ardhura të këshillohen dhe përfaqësohen nga avokatja ose avokati. Ndihma ligjore në rrugë jashtëgjyqësore është një ndihmë për mbrojtjen e të drejtave jashtë procedurës ligjore
<b>Ndihma ligjore për procedura ligjore</b>	Përkrahje financiare për zbatimin e procedurave ligjore në rast se dikush nuk ka të ardhura/pasuri (të mjaftueshme)
<b>Njerëz të toleruar</b>	Me durimin vërtetohet pezullimi i dëbimit (nuk jepet leja ligjore e qëndrimit).
<b>Pafuqia</b>	Pafuqia psikike në një situatë
<b>Pagesa sociale për kujdesin për mirëqenie</b>	Ndihmë nga shteti për njerëzit në nevojë për t'u kujdesur për ta. Përfshinë subvencione për qira, ndihma për të papunët apo ndihma të tjera sociale
<b>Pagesa të pensioneve</b>	Të drejta për një shumë parash për arsye të statusit social/të moshës

<b>Partneri intim</b>	Partneri me të cilin keni një marrëdhënie seksuale
<b>Pasiviteti</b>	Apatia, mungesa e aktiviteteve/vullnetit
<b>Pasoja/dëmtime që janë pasoja</b>	Pasojat ose dëmtimet që pasojnë rrethanat. Për shembull, probleme psikike që rezultojnë nga përjetime të dhunës
<b>Person i besuar</b>	Dikush tek i cili keni shumë besim
<b>Përkrahja për dëshmitarë</b>	Përkrahja e një avokatit apo avokate për dëshmitarë
<b>Pozita ligjore</b>	Ligje për një temë të caktuar
<b>Privimi i jashtëligjshëm i lirisë</b>	Rrëmbimi i një personi tjetër apo bllokimi, mbajtja, kundër vullnetit të tij, ose pengimi i largimit nga një person tjetër
<b>Procedura penale</b>	Ndjekja penale e një vepre penale
<b>Prostitucioni i detyruar</b>	Trafikimi i qenieve njerëzore për qëllimin e shfrytëzimit seksual
<b>Psikik</b>	që lidhet me gjendjen shpirtërore
<b>Psikosomatik</b>	Sëmundje fizike që rezultojnë tërësisht apo pjesërisht nga shkaqe psikike
<b>Psikoterapia</b>	Terapia për trajtimin e çrregullimeve psikike apo pasojave psikike
<b>Qendra të specializuara konsulente</b>	Qendrat e specializuara të konsulencës janë të specializuara në tema dhe çështje të ndryshme në përgjegjësi informacione, këshilla, shoqërim, tregimin e mundësive për të vepruar dhe kontakte të mëtejshme me persona të specializuar për çështjet ku punojnë
<b>Qëndrimi i detyrueshëm</b>	Detyrimi i refugjatëve/azilkërkuesve në Gjermani që të qëndrojnë vetëm në zonën e caktuar
<b>Refugjatë dhe azilkërkues</b>	Azilkërkuesit janë persona të cilët kanë kërkuar mbrojtje në territorin e Republikës Federale të Gjermanisë për shkak të përndjekjes politike, dëbimit ose për shkak një kthimi tjetër në një shtet, në të cilin atyre ju kërcënohet përndjekja ose dëme serioze
<b>Rreziku</b>	Rrethana që rrisin probabilitetin që dikush të bëhet i sëmurë për shembull një sëmundje psikike për shkak të përjetimeve të dhunshme
<b>Rreziku i mirëqenies së fëmijës</b>	Gjendja në të cilën një fëmijë nuk ndihet mirë dhe mirëqenia e tij/saj rrezikohet. Për shembull, nëse një fëmijë është ekspozuar ndaj dhunës në familje
<b>Situata ligjore</b>	Ligje për një çështje të caktuar
<b>Spastrimi etnik</b>	Heqja e grupeve (fetare) të caktuara të popullsisë nga vendi/rajoni që ndodh shpesh në mënyrë të dhunshme



<b>Stigmatizimi</b>	Zhvillimi gjatë të cilit u atribuohen tipare të caktuara negative personave apo grupeve dhe personat dhe grupet në fjalë klasifikohen në këtë mënyrë në një kategori të caktuar
<b>Struktura patriarkale</b>	Forma e shoqërisë në të cilin meshkujt kanë, në parim, më shumë pushtet, fuqi dhe gëzojnë më shumë të drejta sesa femrat
<b>Shfrytëzimi</b>	Marrëdhënie të padrejta ndërmjet personave. Nënkuptoet keqpërdorimi i gjendjes së vështirë ose situatës së dobët të një viktime
<b>Shkelje e kufijve</b>	Çdo veprim që kryhet pa konsiderate për vullnetin apo inferioritetin fizik, psikik, njohës apo gjuhësor të personit tjetër për të plotësuar nevojat e veta
<b>Shtrëngimi</b>	Detyrimi i një presoni që të bëjë diçka (kundër vullnetit të tij)
<b>Tolerancë</b>	Pajtimi i një personi
<b>Trafikimi i femrave</b>	Hyrja e një femre në një shtet mbi bazën e premtimeve të rreme, gënjeshtrave apo mashtrimeve, nëse asaj i duhet të paguajë borxhe apo shuma të tepërta për ndërmjetësim tek agjentë apo shërbime gjatë një periudhe të gjatë kohore nëse ajo i nënshtrohet dhunës, presionit, apo kanosjes dhe kërcënimeve, apo nëse shtrëngohet të shfrytëzohet për punë
<b>Traumatizmi</b>	Një ngjarje të cilën dikush nuk mund ta kapërcejë, e cila shkakton një sëmundje psikike afatgjatë
<b>Ushtrimi i pushtetit</b>	Zotërimi/dominimi/kontrolli shfrytëzimi i një personi tjetër
<b>Vende të sigurta për femra/ institucione për femra</b>	Institucione dhe qendra strehimi që ofrojnë mbrojtje dhe përkrahje posaçërisht për femra
<b>Vendi i pranimit</b>	Një vend që pranon refugjatë ose emigrantë/ku personat në fjalë gjejnë strehim dhe mund të jetojnë
<b>Vetëmbrojtje</b>	Aftësia për të mbrojtur veten nga rreziqet

# Adresa të zgjedhura kontakti

---

## **Anti-Diskriminierungsstelle des Bundes**

Glinkastraße 24

10117 Berlin

Tel.: 030 185551865

Orari: e hënë – e premte ora

09:00 – 12:00 dhe ora 13:00 – 15:00

E-mail: [beratung@ads.bund.de](mailto:beratung@ads.bund.de)

[www.antidiskriminierungsstelle.de](http://www.antidiskriminierungsstelle.de)

## **Zyra federale kundër diskriminimit**

Këshillim për të drejtat në raste diskriminimesh,  
kontaktim me specialistë rajonalë.

---

## **Bff – Bundesverband Frauenberatungsstellen und Frauennotrufe**

**Frauen gegen Gewalt e.V.**

Petersburger Straße 94

10247 Berlin

Tel.: 030 32299500

Orari: e hënë – e enjte ora 10:00 – 17:00,

e premte ora 10:00 – 14:00

E-mail: [info@bv-bff.de](mailto:info@bv-bff.de)

Faks: 030 32299501

[www.frauen-gegen-gewalt.de](http://www.frauen-gegen-gewalt.de)

## **Bff – Federata “Këshillimoret për femra dhe numrat për thirrje emergjente për femra”**

**Femra kundër dhunës, shoqatë e regjistruar**

Organizata që vepron në të gjithë Gjermaninë dhe që  
angazhohet për femra të prekura nga dhuna.

Baza e të dhënave me këshillimoret rajonale, me numrat  
për thirrje emergjente për femra dhe me strehimoret  
për femra në:

[www.frauen-gegen-gewalt.de/organisationen.html](http://www.frauen-gegen-gewalt.de/organisationen.html).

Informatat edhe në arabisht, anglisht dhe turqisht.

---

## **Bundesarbeitsgemeinschaft der Kinderschutz-Zentren e.V.**

Bonner Straße 145

50968 Köln

Tel.: 0221 569753

E-mail: [die@kinderschutz-zentren.org](mailto:die@kinderschutz-zentren.org)

Faks: 0221 5697550

[www.kinderschutz-zentren.org](http://www.kinderschutz-zentren.org)

## **Grupi federal i punës i qendrave për mbrojtjen e fëmijëve, shoqatë e regjistruar**

Këshillim për fëmijët dhe familjet, që janë prekur nga  
dhuna dhe nga krizat e rënda, ofertat e ndihmave  
parandaluese, mundësia për shkrimin spitalor

afatshkurtër të fëmijëve. Baza e të dhënave me qendrat  
rajonale për mbrojtjen e fëmijëve në: [www.kinderschutz-zentren.org/zentren-vor-ort](http://www.kinderschutz-zentren.org/zentren-vor-ort)

---

## **Bundesarbeitsgemeinschaft Täterarbeit Häusliche Gewalt (BAG TäHG e.V.)**

Hohenzollernring 106

13585 Berlin

Kontakt: Danelia Krüger

Tel.: 0162 1398443

E-mail: [danelia.krueger@bag-taeterarbeit.de](mailto:danelia.krueger@bag-taeterarbeit.de)

## **Grupi federal i punës “Puna me autorin e krimit”**

**“Dhunë familjare”, shoqatë e regjistruar (BAG TäHG e.V.)**

Federata ndërkulturore për institucionet e punës me  
autorin e krimit në rastet e dhunës familjare në Gjermani,  
mundëson edhe mbrojtjen e viktimës dhe punon për  
parandalimin e dhunës.

---

**Deutsche Gesellschaft für  
Prävention und Intervention  
bei Kindesmisshandlung und  
-vernachlässigung e.V.**

Sternstraße 9 – 11  
40479 Düsseldorf  
Tel.: 0211 4976800  
E-mail: [info@dgfpi.de](mailto:info@dgfpi.de)  
Faks: 0211 49768020  
[www.dgfpi.de](http://www.dgfpi.de)

**Shoqëria gjermane për parandalim dhe intervenim në  
rastet e maltretimit të fëmijëve dhe të lënies pas dore  
të fëmijëve, shoqatë e regjistruar**

Lidhja e specialistëve (persona dhe institucione) nga i  
gjithë Territori Federal dhe të vendeve fqinje, të cilët së  
bashku i kanë vënë vetes si synim të ndërhyjnë për një  
përmirësim të mbrojtjes së fëmijëve në mënyrë aktive.

---

**Deutsches Institut für Menschenrechte**

Zimmerstraße 26/27  
10969 Berlin  
Tel.: 030 259359-0  
E-mail:  
[info@institut-fuer-menschenrechte.de](mailto:info@institut-fuer-menschenrechte.de)  
Faks: 030 259359-59  
[www.institut-fuer-menschenrechte.de](http://www.institut-fuer-menschenrechte.de)

**Instituti gjerman për të drejtat e njeriut**

Instituti informon publikun për gjendjen e të drejtave  
të njeriut brenda dhe jashtë vendit dhe kontribuon për  
parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut si dhe  
për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

---

**Frauenhauskoordinierung e.V.**

Tucholskystraße 11  
10117 Berlin  
Tel.: 030 33843420  
E-mail: [info@frauenhauskoordinierung.de](mailto:info@frauenhauskoordinierung.de)  
Faks: 030 338434219  
[www.frauenhauskoordinierung.de](http://www.frauenhauskoordinierung.de)

**Koordinimi i strehimoreve për femra, shoqatë e  
regjistruar**

Organizatë që vepron në të gjithë Gjermaninë dhe  
që angazhohet për femra të prekura nga dhuna.  
Baza e të dhënave me këshillimoret rajonale në:  
[www.frauenhauskoordinierung.de/  
beratungsstellensuche.html](http://www.frauenhauskoordinierung.de/beratungsstellensuche.html)  
Baza e të dhënave me strehimoret rajonale për  
femra në: [www.frauenhauskoordinierung.de/  
frauenhaussuche.html](http://www.frauenhauskoordinierung.de/frauenhaussuche.html)  
Gjithashtu konsiderimi i gjuhëve dhe i tipareve të  
tjera të ofertave për ndihmë.

---

**Hilfetelefon Gewalt gegen Frauen**

Tel.: 08000 116016  
Orari: e hënë – e diel, 24 orë  
[www.hilfetelefon.de](http://www.hilfetelefon.de)

**Numër për ndihmë “Dhunë kundër femrave”**

Këshillim falas dhe anonim në telefon. Edhe në  
këto gjuhë: shqip, arabisht, bullgarisht, kinezisht,  
darisht/persisht, anglisht, frëngjisht, italisht, kurdisht  
(kurmanxhisht), polonisht, portugalisht, rumanisht,  
serbisht, spanjisht, rusisht, turqisht, vietnamesisht.  
Këshillim me E-mail, çat në takime të pajtuara,  
shërbim emergjence 24-orësh

---

---

**Hilfetelefon Sexueller Missbrauch**

Tel.: 0800 2255530

**Numër për ndihmë "Abuzim seksual"**

Falas & anonim, këshillim telefonik në rastin e dhunës seksuale.

Lista e institucioneve rajonale që ofrojnë ndihmë, edhe për refugjatë.

---

**Jugendportal zwangsheirat.de**

Brunnenstraße 128

13335 Berlin

Tel.: 030 4050469930 (falas)

Orari: E hënë ora 15:00 – 18:00,

e martë + e enjte ora 10:00 – 13:00

E-mail: [info@frauenrechte.de](mailto:info@frauenrechte.de)

Faks: 030 40504699-99

[www.zwangsheirat.de](http://www.zwangsheirat.de)

---

**Portali rinor për martesën e detyruar (zwangsheirat.de)**

Numër krize kundër martesës së detyruar. Ofron këshillim online, një blog si dhe një funksion kërkimi për këshillimore në të gjithë Gjermaninë.

---

**KOK – Bundesweiter Koordinierungskreis gegen Menschenhandel e.V.**

Kurfürstenstraße 33

10785 Berlin

Tel.: 030 26391176

E-mail: [info@kok-buero.de](mailto:info@kok-buero.de)

Faks: 030 26391186

[www.kok-gegen-menschenhandel.de](http://www.kok-gegen-menschenhandel.de)

---

**KOK – Rrethi koordinues për të gjithë Gjermaninë kundër trafikimit të njerëzve, shoqatë e regjistruar**

Shoqata angazhohet në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar për luftimin e trafikimit dhe të shfrytëzimit të njerëzve si dhe për realizimin e të drejtave të personave të prekur, dhe ajo angazhohet për realizimin e të drejtave të njeriut për migrantë dhe migrante.

---

**Krankenhäuser****Spitale**

Shih listën rajonale në numërorin telefonik, mund të pyesni gjithashtu pranë institucioneve për refugjatë, tek mjekë, në zyrat e sigurimit shëndetësor dhe tek persona të tjerë të kontaktit

---

**Notfall-Nummern**

112 (shërbimi i shpëtimit/zjarrfikësja)

110 (policia)

---

**Numra emërgjence**

Falas, ndihmë në emërgjence shëndetësore (shërbimi i shpëtimit), zjarr (zjarrfikësja), rreziqe personash (policia)

---

---

**Notruf und Beratung für vergewaltigte Frauen und Mädchen e.V.**

Kasseler Straße 1a  
60486 Frankfurt am Main  
Tel.: 069 709494  
E-mail: [info@frauennotruf-frankfurt.de](mailto:info@frauennotruf-frankfurt.de)  
Faks: 069 79302795  
[www.soforthilfe-nach-vergewaltigung.de](http://www.soforthilfe-nach-vergewaltigung.de)

**Numër për thirrje emërgjente dhe këshillim për gra dhe vajza të përdhunuara, shoqatë e regjistruar**  
Ofron të gjitha informatat e rëndësishme për ndihma mjekësore pas një përdhunimi, duke përfshirë një sigurim të bësueshëm të gjurmëve.

---

**Nummer gegen Kummer  
Telefon-Beratung bei Sorgen und Nöten**

Numri për fëmijë dhe adoleshentë:  
Tel: 116111  
Orari: e hënë – e shtunë ora 14:00 – 20:00  
Numri për prindër: Tel.: 0800 1110550  
Orari: e hënë – e premte ora 09:00 – 11:00  
dhe e martë + e enjte ora 17:00 – 19:00

**Numri kundër brengut  
Këshillim telefonik për shqetësime dhe halle**  
Falas dhe anonim nga celulari dhe telefoni fiks.  
Ndihmë këshilluese në të gjithë Gjermaninë për fëmijë, adoleshentë dhe prindër në rastin e krizës si dhe në rastin e dyshimit për rrezikimin e mirëqënies së fëmijës.

---

**TERRE DES FEMMES  
Menschenrechte für die Frau e.V.**

Brunnenstraße 128  
13355 Berlin  
Tel.: 030 4050469930  
Orari: e hënë ora 15:00 – 18:00,  
e martë + e enjte ora 10:00 – 13:00  
E-mail: [info@frauenrechte.de](mailto:info@frauenrechte.de);  
[beratung@frauenrechte.de](mailto:beratung@frauenrechte.de)  
Faks: 030 40504699-99  
[www.frauenrechte.de](http://www.frauenrechte.de)

**TERRE DES FEMMES  
Të drejtat e njeriut për femrën, shoqatë e regjistruar**  
Organizata jo fitimprurëse për të drejtat e njeriut për femrat këshillon personalisht, me telefon dhe online.  
Këshillim në gjermanisht dhe turqisht.

---

**Unabhängige Patientenberatung  
Deutschland**

Tel. arabisht: 0800 33221225  
e martë 11:00 – 13:00 Uhr  
e enjte: 17:00 – 19:00 Uhr

Tel. gjermanisht: 0800 0117722  
e hënë – e premte: 08:00 – 22:00 Uhr  
e shtunë: 08:00 – 18:00 Uhr

Tel. rusisht: 0800 011 77 24  
e hënë – e shtunë: 08:00 – 18:00 Uhr

Tel. turqisht: 0800 0117723  
E hënë – e shtunë: 08:00 – 18:00 Uhr

Këshillim pacientësh online në  
<https://online.patientenberatung.de/>

**Këshillimi i pavarur i pacientëve i Gjermanisë**

Informata për shërbimin shëndetësor në Gjermani (pavarur nga sigurimi shëndetësor!), këshillim telefonik falas për celular dhe telefon fiks. Këshillimi i mundur në arabisht, gjermanisht, rusisht dhe turqisht.

---

**Weisser Ring**

Numri për viktimë: 116 006  
[www.weisser-ring.de](http://www.weisser-ring.de)

**Unaza e bardhe**

Falas & anonim, këshillim telefonik, intervenim në emergjenca/kriza, mundësim kontaktimi, ndihmë juridike, shoqërim personal

---

**Zentrale Informationsstelle  
Autonomer Frauenhäuser**

Markt 4  
53111 Bonn  
Tel.: 0288 68469504/-05  
Orari: e hënë + e premte ora 09:00 – 13:00,  
e mërkurë ora 14:00 – 17:00  
E-mail: [zif-frauen@gmx.de](mailto:zif-frauen@gmx.de)  
Faks: 0228 68469506  
[www.autonome-frauenhaeuser-zif.de/de/autonome-frauenhaeuser/adressliste](http://www.autonome-frauenhaeuser-zif.de/de/autonome-frauenhaeuser/adressliste)

**Zyra qendrore informative e strehimoreve  
autonome për femra**

Baza e të dhënave me strehimoret rajonale për femra

---



# Mbrojtja dhe siguria nga dhuna për femra dhe të rinj refugjatë në Gjermani

Ky udhëzues përmban informacione rreth temës së mbrojtjes dhe sigurisë nga dhuna për femra refugjate, emigrante dhe të rinj në Gjermani. Prandaj ky udhëzues u ofron femrave refugjate dhe fëmijëve, por edhe femrave emigrante që jetojnë këtu, informacione të përkrahjes në rast se kërcënohen nga dhuna apo që kanë përjetuar dhunë:

- Dhuna para, gjatë dhe pas ikjes
- Shkaqet, format dhe pasojat e dhunës
- Kush ushtron dhunë?
- Rugëdalja nga dhuna
- Adresa për oferta në ndihmë të personave të cenuar dhe familjarëve të tyre

Ky udhëzues është zhvilluar në kuadër të projektit “MiMi parandalimi i dhunës për emigrante dhe emigrantë” në gjithë Gjermaninë.

Porositje mund të kryhen përmes faqeve të internetit “[www.mimi-gegen-gewalt.de](http://www.mimi-gegen-gewalt.de)” dhe “[mimi-bestellportal.de](http://mimi-bestellportal.de)”.

Mbështetur nga:



**Ethno-  
Medizinisches  
Zentrum e.V.**



Ky udhëzues ju është dhënë nga: